

Ne fokus/ Tifozet e Tiranës i kerkojne Bashës te largohet

nga AlbaniaSoccer

E hënë, 11 Nentor 2013 22:45



Te acaruar nga gjendja e mjeruar ku është përfshirë Tirana, tifozet bardheblu me në krye ata me fanatikët kanë bërë një deklaratë për mediat ku kanë kërkuar të largohen të gjithë, nga kryetari i bashkisë Basha, tek Alimehmeti, Fortuzi, Mema apo dhe treneri Gallo dhe lojtarët e skuadrës. “Duhej të preknim fundin për të kuptuar se premtimet ishin mashtrime. Paaftësia dhe dashakeqësia ka dëmtuar Tironën e tani shohim se nesër nuk do të jete si dje. Është momenti që nga i pari tek i fundit të dorëzoni çelsat e uniformat e të shkonit në shtëpi. Nuk jeni për Tironën dhe nuk e meritoni këtë klub. Nga i pari tek i fundit pa përjashtuar askënd. Premtuat Tironën Europiane për të na dëgdisur të fundit në një realitet që ne nuk e kemi njohur për afro një shekull. Zoti kryetar i bashkisë, zoti Lulezim Basha. Faleminderit për të gjitha mashtrimet, por tani është momenti të heqesh dorë. Tirona nuk ka nevojë për premtime, buzeqeshje dhe fjale boshe. Hiq dorë dhe mos dëmto me një nga vlerat më të mëdha që ka kryeqyteti dhe jo vetëm. Zoti administrator i klubit, zoti Alimehmeti. Faleminderit për gjithçka që dhënë si lojtar në fushë, por me Tironën e zyrave nuk mundesh të besh me asgjë pasi në nëntë muaj prishe dhe dëmtove atë që gjete. Dorëzo detyrën dhe largohu. Zotërinj të nderuar të bordit drejtues, ikona bardheblu: Zoti Fortuzi, zoti Mema, por dhe të tjerët që premtuan me pak se ju e për pasoje mashtruan me pak. Nuk keni si të largoheni pasi jeni larguar tashmë, por tani ju duhet të kerkoni falje publike për gjithçka që thate e shkelet. Zotërinj sponsorë, zoti Babasi, zoti Halili e zoti Morina. Faleminderit për kontributin tuaj, pasi po e bëni atë që keni marrë përsiper, por për Tironën kuptojmë se nuk është kjo zgjidhja. Të nderuar punjones militant të klubit. Është momenti të hiqni dorë nga rroga mujore pasi nuk keni të drejtë të paguheni për paaftësinë tuaj. Në fund, po jo për nga rëndësia një kerkese edhe për 25 futbollistët e Tironës. Dorëzoni fanellat përpara se t’ju marrim në ato. Një kerkese edhe për ish trajnerin Dede apo dhe atë që ka marrë përsiper ta zëvendësojë zotin Gallo. Largohuni duke kërkuar falje për demin sportiv dhe moral që i keni bërë Tironës. Nis sot, për të vazhduar deri në gjetjen e një zgjidhje, reaguimi si reagon i natyreshëm për dëmet që ju keni bërë në pak kohë. Tirona na perket dhe Tirona jemi ne. Të gjithë ato që kanë kontribuar për këto situata të turpshme do të marrin faturën. Në kurrë nuk dorëzohemi. Gjithmone me këken lart”, thuhet në deklaratën e tifozëve “Fanatics”.